



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 2906/20
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, ta datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dërmaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës Kolegjit Globus nr.1206/20H, datë 14.08.2020, kundër Vendimit të KSHC Nr. 986/20D, të datës 21.07.2020 për refuzimin e kërkesës për akreditimi institucional dhe akreditimin e programeve, e pranuar më datë 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës 11.11.2020, me votim unanim, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Kolegjit Globus nr.1206/20H, datë 14.08.2020 dhe vërtetohet Vendimi i KSHC-së nr. 986/20D, të datës 21.07.2020.

ARSYETIM

Kolegji Globus më datë 14.08.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar Ankesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes së cilës ka kërkuar që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të rishqyrtoj vendimin e tij të datës 21.07.2020, nr. 986/20D, me të cilin është refuzuar kërkesa për akreditim institucional dhe të programeve. Pala me Ankesën e datës 14.08.2020 pretendon se:

Këshilli Shtetëror i Cilësisë pa të drejtë ka refuzuar akreditimin institucional dhe akreditimin e programeve duke bërë:

- Shkelje të procedurës administrative;
- Konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike
- Zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Provat e administruara:

- Vendimi i KSHC-së Nr. 974/20D
- Njoftimi i AKA-së i datës 20.01.2020;

- Raporti i Vetëvlerësimit i Kolegjit Globus;
- Raporti i KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës nga takimi i datës 02.09.2020

Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi

Komisioni i Ankesave pranë AKA-së, ka pranuar ankesën e datës 14.08.2020 të Kolegjit Globus më datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

KSHC pas verifikimit të dokumentacionit, ka vërtetuar se këta të fundit kanë dorëzuar Raportin e Vetëvlerësimit pas afatit të caktuar kohorë, gjë që është në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1.4.2. të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Kolegji Globus pretendon se Raporti i vetëvlerësimit është paraqitur me vonesë për shkak të kërkesës së anëtarëve të KSHC-së me udhëzime për ndryshime të programeve të paraqitura për akreditim.

Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Kolegjit Globus është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për refuzimin e akreditimit institucional dhe akreditim të programeve.

Komisioni i Ankesave e ka verifikuar se Raporti i Vetëvlerësimit për akreditim institucional dhe të programeve nga ana e Kolegjit Globus është dorëzuar në AKA me datë 04.03.2020, derisa njoftimi për aprovimin formal është bërë më datë 20.01.2020, e derisa i njëjti duhet të ishte dorëzuar më së largu 1 muaj pas aprovimit formal të aplikacionit nga KSHC. Si pasojë e paraqitjes së këtij raporti pas afatit kohorë është refuzuar akreditimi institucional i Kolegjit Globus e rrjedhimisht edhe akreditimi i programeve të studimit.

Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret

Bazuar në nenin 10, paragrafi 1.4.2. të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili përcakton se: ” *Me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së vlerësuesve të jashtëm gjatë shqyrtimit të RVV-ve, dhe me qëllim që RVV-të të përmbajnë të dhëna të aktualizuara, RVV duhet të silltet në AKA, më së largu 1 muaj pas aprovimit formal të aplikacionit nga KSHC, Në rast se institucioni nuk arrin të dorëzoj RVV-në brenda afatit kohor prej një muaji, aplikacioni i institucionit procedohet në mbledhjen e KSHC-së për refuzim të aplikacionit*”.

Nga kjo, derisa është provuar se Raporti i Vetëvlerësimit të Kolegjit Globus për akreditim institucional dhe të programeve është paraqitur pas kalimit të afatit kohorë, Komisioni i Ankesave konstaton se KSHC ka vepruar në përputhje me nenin 10, paragrafi 1.4.2. të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Pala me datë 29.10.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parasheh nenin 95 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji Globus e ka realizuar këtë të drejtë dhe ka mbrojtur pretendimet e veta.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Komisioni i Ankesave në AKA

KA/Nr. 2906/20, datë 28/11/2020

Procesmbajtësi



Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave



Faton Merovci

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.